



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



## RREGULLORE

PËR

PËRMBAJTJËN E SIMBOLEVE KOMUNALE, SI DHE PËR PROCEDURËN, MËNYRËN  
DHE KUSHTET PËR NDARJËN E TITUJVE TË NDERIT, ÇMIMEVE, MIRËNJOHJEVE  
DHE SHPËRBLIMEVE TJERA

Klinë, korrik 2015

Në bazë të nenit 11 si dhe në pajtim me nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja (c), pastaj nenit 7 e lidhur më nenin 40 parag. 40.2 nenë (h.) të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale („Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës“, nr. 28/2008), nenit 8 parag. 3 të Statutit të Komunës se Klinës, pas përfilljës se procedurës se rregullt të inicimit dhe diskutimit publik, Kuvendi i Komunës se Klinës në seancën e vetë të rregullt të VII-ën më radhë për vitin 2015, të mbajtur më dt. 20.07. 2015, **miraton**:

## RREGULLORE

PËR

**PËRMBAJTJËN E SIMBOLEVE KOMUNALE, SI DHE PËR PROCEDURËN, MËNYRËN DHE KUSHTET PËR NDARJËN E TITUJVE TË NDERIT, ÇMIMEVE, MIRËNJOHJEVE DHE SHPËRBLIMEVE TJERA**

### I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qellimi

Me këtë Rregullore, në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës dhe aktet e tjera pozitive, rregullohet forma, përbajtja dhe procedura e caktimit të simboleve komunale, ndarja e titujve të nderit, dekoratave, pllaketave, medaljeve, mirënjojheve dhe falënderimeve dhe shpërblimeve të tjera personaliteteve të shquara dhe subjekteve të tjera, të cilat, në lëmi të caktuara, kanë dhënë kontributin e vet të shquar për qytetarët e Komunës se Klinës dhe më gjërë.

Neni 2

**Procedura, kriteret dhe kushtet për caktimin dhe rregullimin e simboleve komunale**

Kuvendi i Komunës miraton dhe ndryshon simbolet komunale, siç janë: stemat, vulat, emblemat dhe flamujt komunal, në përputhje me dispozitat kushtetuese, të ligjeve përkatëse, të Statutit të Komunës dhe të kësaj rregulloreje.

Neni 3

**Ndarja e titujve, çmimeve, mirënjojheve dhe shpërblimeve tjera**

1. Kuvendi i Komunës, në përputhje me dispozitat ligjore dhe aktet e tjera nënligjore, si dhe më dispozitat tjera të kësaj rregullorje përcakton kushtet dhe kriteret e ndarjës se titujve të nderit, çmimeve dhe shpërblimeve tjera, si nga neni 1 dhe 14 i kësaj rregullorje.

2. Titujt e nderit si dhe të gjitha shperblimet tjera ndahën dhe jepën për kontributet të veçanta që kanë dhënë personalitet e shquara dhe subjektet e tjera juridike, në lëmenjtë e humanizmit, sakrificës, kulturës, artit, letërsisë, sportit dhe aktivitete të tjera në Komunën e Klinës.

3. Simbolet e Komunës se Klinë janë të rregulluara edhe më dispozitën e nenit 5 dhe 6 të Statutit të komunës.

4. Titujt, çmimet dhe shperblimet tjera sipas kësaj rregullorje janë:

- 4.1 Titulli "Qytetar Nderi",
- 4.2 Titulli "Nderi i Qytetit",
- 4.3 Titulli „4 Prilli Dita e të Zhdukurve",
- 4.4 Titulli "Pena e Artë",
- 4.5 Titulli "Sportist i Vtit",
- 4.6 Çmimi i Festivalit tradicional vjetor „I Këndoym Lirisë",
- 4.7 Çmimi „Dita e Çlirimit të Klinës 18 Qershori,, ,
- 4.8 Çmimi vjetor tradicional për Arte të bukura pamore dhe „Arte figurative,, ,
- 4.9 Çmimi Vjetor Tradicional letrar „Ora e Tahir Deskut,,
- 4.10 Mirnjohnja „Frrok Gojani,, në lëmin e Arsimit,
- 4.11. Mirnjohnja „Azem Desku,, në lëmin e shendetësisë, si dhe
- 4.12 Mirënjohnja „Flaka e Janarit,, në lëmin e kulturës.

5. Mirënjohnjet nga pika 4.10 pastaj 4.11 si dhe 4.12 nuk kan implikime financiare.

6. Përveq tituve, çmimeve dhe mirënjohnjeve të lartcekura në paragrafin 4 të këtij neni ndahën e edhe: Dekorata, Plaketa dhe Shperblime tjera adekuate.

7. Titujt dhe çmimet ndahën sipas dispozitave të kësaj rregullorje nga neni 4 deri në nenin 12 e lidhur më nenin 14, përderi sa qe mirënjohnjet dhe falenderimet ndahën sipas kushteve dhe kritereve nga neni 13 i kësaj rregullorje.

#### Neni 4.

##### **Titujt dhe ndarja e tyre**

###### **1. Titulli „Qytetar nderi,,**

1. Titulli "Qytetar Nderi", është titulli më i lartë që u jepet personaliteteve të larta politike, shoqërore, shkencëtarëve, artistëve, të huajve që vizitojnë qytetin e Klinës, në shenjë respekti, miqësie apo mirënjohnjeje për kontributet të rëndësishme e të veçanta në fusha të ndryshme në të mirë të qytetarëve. Po ashtu, ky titull u jepet personaliteteve të ndryshme, të cilat në kohët më të vështira ndihmuant rrugëtimin e popullit të Kosovës dhe Luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për Liri dhe Pavarësi.

2. Titulli përbëhet nga një "çelës", i cili simbolizon çelësin e portës së Komunës si dhe një certifikatë solemne, të shkruar në gjuhën shqipe dhe në gjuhën amtare të atij që i jepet.

3 Çelësi ka gjatësi 30 cm, ngjyrë ari, emrin dhe mbiemrin e bartësit të shpërblimit, të shkruar me shkronja të graviuara në pjesën e dorezës dhe teksti, „Qytetar nderi i Komunës së Klinës”.

4. Çertifikata shkruhet në letër të fortë cilësore prej së paku 150 gr, formati A-4, me ngjyrë ari, në sfondin e së cilës është emblema e Komunës së Klinës. Në pjesën e sipërme të certifikatës shkruhet baza ligjore: “ Në bazë të nenit përkatës të Statutit të Komunës së Klinës, Kuvendi i Komunës së Klinës, në seancën e vet solemne, të mbajtur më datën përkatëse /lihet vendi për datën e seancës/, lëshon këtë Çertifikatë” (në kryerresht, në mes, me shkronja solemne). Pastaj, në kryerresht shkruhet : “ Z. (emri dhe mbiemri i fituesit të shpërblimit, vendbanimi, komuna, shteti), është Qytetar nderi i Komunës së Klinës, me të gjitha obligimet dhe privilegjet që ky shpërblim parasheh”. Në kryerresht shkruhet numri i

protokolit të certifikatës dhe data, ndërsa nën te shkruhet: “Kuvendi i Komunës së Klinës”. Një radhë më poshtë, në anën e djathë të certifikatës, shkruhet emri, mbiemri dhe nënshkrimi i Kryetarit te Komunës, kurse në anën e majtë shkruhet emri, mbiemri dhe nënshkrimi i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës dhe në mes vula e Komunës.

5. Kuvendi i Komunës faktin e ndarjes së titullit e evidenton në regjistrin e veçantë të Qytetarëve të Nderit të Komunës së Klinës, të cilin e mban Kryetari i Komunës së Klinës.

6. Titullin e jep Kuvendi i Komunës në mbledhje solemne, sipas procedurave të parapara me dispozitat e kësaj rregulloreje.

7. Propozimin për ndarjen e këtij titulli mund ta japë Kryetari i Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa dhe së paku 1/3 e Këshilltarëve të Kuvendit Komunal.

Iniciativën për dhënien e këtij titulli mund ta japë cilido institucion i komunës, ose së paku, 700 qytetarë të Komunës së Klinës.

8. Iniciativa dhe propozimet nga pikë 4.7 i dorëzohen për procedim të mëtejmë komisionit vlerësues te zgjedhur në Kuvendin Komunal, i cili vepron sipas procedurave të parapara me dispozitat e kësaj rregulloreje.

## Neni 5

### 2. Titulli „Nderi i qytetit,,

1. Titulli ”Nderi i Qytetit” është titull që u jepet personalitetevë të shquara të qytetit që kanë dhënë kontribute të veçanta dhe tepër të rëndësishme, të cilët kanë lartësuar emrin e qytetit, që kanë një veprimtari të gjerë dhe të rëndësishme në dobi të qytetarëve, vlera të veçanta dhe shumë të njohura në rrafshin kombëtar, që janë personalitetë të rëndësishme në fusha të veçanta të shoqërisë, shkencës, artit dhe sportit, që kanë formuar një figurë të pastër dhe që kanë cilësi të larta njerëzore.

2. Ky titull u ndahet, atyre qytetarëve që realizojnë akte të larta humanizmi, heroizmi dhe sakrifica sublime.

3. Titulli përbëhet, nga pllaketa dhe fletëmirënjojja.

4. **Plaketa** ka formë të rrumbullakët, është e punuar në bronz, e praruar në ar, me diametër 7 cm, në mesin e së cilës gjendet emblema e Komunës me emërtimin: Kuvendi i Komunës së Klinës. Nën të shkruhet emri dhe mbiemri i fituesit, ndërsa në pjesën e poshtme te saj shkruhet data e dhënieve.

5. **Fletëmirënjojja** përbëhet nga një fletë e kualitetit cilësor, të dimensionit A 3, peshë 150 gramëshe dhe në tërë sfondin e fletës është emblema e Komunës, kurse ne pjesën e sipërme të saj shkruhet: Kuvendi i Komunës së Klinës dhe numri dhe data e dhënieve se titullit. Në mesin e fletës shkruan: Titulli „Nderi i Qytetit,, me emrin dhe mbiemrin e fituesit, nën të motivacioni i dhënieve se saj. Një radhë më poshtë, në anën e djathtë të certifikatës, shkruhet emri, mbiemri dhe nënshkrimi i Kryetarit të Komunës, në anën e majtë shkruhet emri, mbiemri dhe nënshkrimi i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës dhe në mes vula e Komunës.

6. Propozimet për dhëni e këtij titulli te lartë duhet të bëhen nga institucione të rëndësishme shtetërore, apo të qeverisjes vendore, së bashku me shoqata dhe grupe qytetarësh, duke mundësuar një koncessus të gjerë e të nevojshëm. Ato duhen të shoqërohen me biografi dhe dokumente, dëshmi dhe vlerësime të nevojshme të veprimtarisë së personalitetit të propozuar.

7. Iniciativa dhe propozimet, nga pikë 5.6 i dorëzohen për procedim të mëtejmë komisionit të zgjedhur në Kuvendin e Komunës, i cili vepron sipas procedurave te parapara me dispozita të kësaj rregulloreje.

## Neni 6

### 3. Titulli „4 Prilli Dita e të Zhdukurve,,

1. Titulli, “4 Prilli Dita e të Zhdukurve” ndahet nga Kuvendi i Komunës sipas meritave adekuate dhe ndërlidhet më dt. 04 prill si Dita e të Zhdukurve të Komunës se Klinës.

2. Ky titull jepet për merita dhe kontributë të jashtëzakonshme në fushën e humanizmit. U jepet personaliteteve të shquara të qytetit të Klinës dhe më gjerë që kanë dhënë kontributë të shquara në të mirë të kombit kanë një veprimtari të rëndësishme dhe të gjerë në fusha profesionale dhe intelektuale, në rrafshin kombëtar, që kanë formuar një personalitet të pastër dhe kanë shfaqur cilësi të larta njerëzore në fushën e humanizmit dhe sakrificës sublime.

3. Ky titull u jepet edhe pas vdekjes personaliteteve të kulturës dhe jetës shoqërore që janë lartësuar në memorjen e qytetit për vlera të rralla intelektuale, profesionale dhe shoqërore.

4. Propozimet për dhënien e këtij titulli duhet të bëhen nga institucionë të rëndësishme shtetërore, apo të qeverisjes vendëse si dhe nga shoqatat dhe grupet e qytetarëve, duke mundësuar një konsensus më të gjerë të nevojshëm dhe të plotësuara me biografi dhe dokumente, dëshmi dhe vlerësimë zyrtare të veprimtarisë së personalitetit të propozuar.
5. Ky titull shoqërohet me pllaketën "4 Prilli Dita e të Zhdukurve" për humanizëm dhe liri dhe Formularin përcjellës të formatit A-4.
6. Pllaketa e punuar me rreth ari prej 25 gramëve, e dimensionit prej 5-10 cm, vendoset në mes të kutisë së formatit A-3. dhe simbolizon emblemën e projektit të të Zhdukurve të Pllaka përkujtimore që gjindet të Fontana e ujit në qënder të qytetit.
7. Në kuti, fillimisht, vendoset Harta dhe Emblema e Komunës se Klinës dhe pllaka e aluminit, ngjyrë ari. Në pjesën e sipërme të kapakut jepet mesazhi i shkurtër për personalitetin të cilit i jepet çmimi, me nënshkrimin e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, në fund në anën e djathtë dhe të Kryetarit të Komunës, në anën e majtë.
8. Formulari është letër cilësore 150 gramëshe, ngjyrë ari, e formatit A-3 dhe ka në fillim emblemën e institucioneve shtetërore, numrin dhe datën e vendimit, nënshkrimin e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, në njëren anë në fund të letrës dhe të Kryetarit të Komunës, në anën tjetër. Në mes jepet vula e komunës. Në mes të letrës, me shkronja të mëdha të shtypit, shënohet emri dhe mbiemri i marrësit të çmimit, me titullin "Plakata e Artë për Liri dhe Humanizëm" dhe fusha e kontributit të dhënë.
9. Materialet si: vendimet, dhënia e çmimit dhe negativi i ndarjes së çmimit ruhen nga ana e Shërbimit Profesional të Kuvendit dhe evidencohen në fletoren e veçantë që përdoret për këto qëllime.

## Neni 7

### 4. Titulli „Pena e artë,,

1. Titulli "Pena e art" u jepet artistëve më të shquar dhe personaliteteve më të rëndësishme të arsimit, artit, shkencës dhe kulturës për aktivitete të evidencuara në nivel kombëtar e ndërkombëtar, të vlerësuar me tituj, urdhëra e medalje për veprimtarinë e tyre krijuese e interpretuese, që kanë një personalitet të pastër qytetarie dhe që gjëzojnë popullaritet në shoqëri.
2. Ky titull u jepet edhe pas vdekjes atyre personaliteteve të qytetit që vazhdojnë të mbeten në memorje si personalitetë të veprimtarisë artistike, krijuese e shkencore, si shembuj të rrallë të vlerave dhe kontributeve të rëndësishme.
3. Titulli përbëhet nga mbishkrimi "Pena e Artë", në sipërfaqe të së cilës vihet emblema e Komunës së Klinës, në pjesën e epërme shkruhet emri i marrësit të çmimit dhe emblema e komunës, në paketimin e së njëjtës me shkronja ngjyrë ari shkruhet: "Pena e artë".

4. "Pena e artë" shoqërohet me një fletëpërcjellje, në të cilën shënohen të dhënat për dhënësin e titullit si dhe të dhënat personale të fituesit të titullit si dhe motivacioni për dhënien e titullit atij fituesi.
5. Gjatë një viti kalendarik titulli mund t'i jepet vetëm një fituesi.
6. Propozimet inicuese për dhënien e këtij titulli mund të bëhen nga organet komunale, ato arsimore, kulturore, sportive, grupet e qytetarëve dhe shoqëria civile .
7. Propozimet inicuese nga pikë 7.6 i dorëzohen për procedim të mëtejmë komisionit te zgjedhur të Kuvendit Komunal, i cili vepron sipas procedurave të parapara me dispozitat e kësaj rregulloreje.

#### Neni 8

##### **5. Titulli „Sportisti i vitit,,**

1. Titulli, " Sportisti i Vitis " u jepet sportistëve më të shquar për kontributet e veçanta dhe tepër të rëndësishme, që kanë krijuar një personalitet të lartë, kanë ndikuar ne zhvillimin e sporteve dhe përgatitjen e brezave të tërë sportistësh, kanë arritur rezultate të larta e të qëndrueshme dhe që kanë treguar cilësi të veçanta njerëzore.
2. Titulli përbëhet nga një medalje me diametër 5 cm ku , në pjesën e lartë nën rrith, shkruhet: "Kuvendi i Komunës së Klinës", më poshtë shkruhet me ngjyrë ari: "Sportisti i Vitis" dhe në pjesën e fundit shkruhet viti i fitimit të medaljes.
3. Medalja shoqërohet me një fletëpërcjellje, në të cilën shkruhen shënimet për dhënësin e titullit dhe shënimet personale të fituesit të titullit si dhe motivacioni për dhënien e titullit atij fituesi.
4. Në një vit kalendarik titulli "Sportist i vitit" mund t'i jepet vetëm një fituesi.
5. Iniciativat dhe propozimet për dhënien e kësaj medaljeje duhet të bëhen nga institucionet e sportit, klubet sportive, shoqatat sportive, grupe sportistesh apo qytetarësh që përfaqësojnë nivelet më të gjerë të komunitetit dhe që shoqërohen me biografi përkatëse, dokumente, dëshmi dhe vlerësime të nevojshme të veprimtarisë së personalitetit të propozuar.
6. Iniciativa dhe propozimet nga pikë 8.5 i dorëzohen për procedim të mëtejmë komisionit te zgjedhur në Kuvendin e Komunës, sipas procedurave te parapara me dispozitat e kësaj rregullorje.

#### Neni 9

## **Çmimet dhe ndarja e tyre**

### **1. Çmimi i Festivalit Tradicional vjetor „I Këndoym Lirisë,,**

1. Festivali Tradicional vjetor „I Këndoym Lirisë,, mbahet për çdo vit dhe ai zgjatë 3 ditë dhe 3 netë dhe atë duke filluar më 6, 7 dhe 8 qershor.
2. Në festival marrin pjesë të gjitha grupet artistike, ansamblet, shoqërit kulturoro-artistike, këngëtaret individual dhe në grup nga të gjitha viset dhe trojet shqiptare.
3. Festivali organizohet nga Keshilli organizativ dhe mbahet nenë patronatin e Kryetarit të Komunës i cili është Kryetar i Keshillit organizativ, përbërja e të cilit organ si dhe detyrat e tija caktohën më vendim të veqant të Kryetarit të Komunës.
4. Këshilli organizativ mund të nxjerr Rregullativ të veqant interne për Organizmin dhe mbajtjen e festivalit „ I Këndoym Lirisë,, duke përcaktuar më për se afermi të gjithë punën e keshillit, të drejtat dhe obligimet e tija si dhe të gjitha llojet e çmimeve qe do të ndahën në natën e tretë përfundimtare të festivalit sipas propozimeve dhe vlerësimeve të jurisë profesionale.
5. Çmimet i vlerëson dhe ndan juria profesionale ndërkaq qe çmimi kryesor është Çmimi për vendin e parë „Mujë Krasniqi-Kapuqi,, i cili përcillet më vlerën perkatese finaciare, si dhe çmimet tjera qe përcaktohën në rregullativën interne të Keshillit organizativ.
6. Dizajnimin e çmimeve, formatin dhe specifikat tjera i përcakton këshilli organizativ ose personi tjetër i autorizuar nga Kryetari i Keshillit organizativ, duke përfshie edhe mënyrën dhe kompetencën e dorzimit të tyre.

## **Neni 10**

### **2. Çmimi Dita e Çlirimit të Klinës „18 Qershori,,**

1. Më rastin e Ditës se Çlirimit të Klinës ndahet Çmimi „18 Qershori,,
2. Më rastin e kësaj dite organizohën aktivitete të larmishme kulturoro-artsitike si dhe mbahet koncerti muzikor në qënder të qytetit.
3. Më mbikqyrjën e organizimit dhe të gjitha aktiviteteve tjera të manifesitmit të Ditës se Çlirimit merret Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ndërkaq drejt për se drejti më organizimet e tillë merret Keshilli organizativ për kremlimin e Ditës se Çlirimit, i formuar nga Kryetari i Komunës.

## **Neni 11**

### **3. Çmimi vjetor tradicional për „Arte figurative,,**

1. Çmimi tradicional për „Arte figurative,, ndahet një herë në vit.
2. Çmimi ka për qellim ngritjën e nivelit dhe opusit krijues në arte të bukura pamore, vizatim, grafik, dizajn, pikturë, skulpturë, multimedia dhe nxitjën e fillimit të një fryme kreative garuese te krijuesit e artit në Komunën e Klinës.
3. Çmimi ndahet pas përfilljës se procedurës se rregullt të Konkursit publik dhe Komisionit vlerësues.
4. Çmimi nga paragrafi 1 i këtij nenit përbëhet nga Çmimi i parë, Çmimi i dytë dhe Çmimi i tretë, vlera e të cilave çmime përcaktohet më vendim të veqant të Kryetarit të Komunës.

#### Neni 12

##### **4. Çmimi vjetor tradicional i Orës letrare „Tahir Desku,,**

1. Më rastin e organizimit të manifestimit tradicional letrar vjetor „Ora e Tahir Deskut, që mbahet nenë patronatin e Kryetarit të Komunës më datën 7 shtator si datë e ditlindjës se shkrimitarit Tahir Desku ndahën tri çmime: Çmimi i parë, dytë dhe çmimi i tretë, vlera e të cilave çmime përcaktohet më vendim të veqant të Kryetarit të Komunës.
2. Çmimet nga paragrafi 1 i këtij nenit kan për qellim hulumtimin dhe promovimin e vlerave letrare, krijimtarisë poetike dhe zbulimin e talentve të rinj nga lëmija letrare, jo vetëm për Komunën e Klinës po edhe më gjërë.

#### Neni 13

##### **Mirënjohjet dhe Falenderimet**

1. „Mirënjohjet”, dhe „Falënderimet, u jepen, në shenjë respekti atyre personaliteteve, të cilat kanë dhënë një kontribut të veçantë, të dallueshëm dhe të rëndësishëm në fusha të ndryshme në të mirë të komunitetit.
2. Fletëmirënjoja dhe Falenderimi përbëhet nga një fletë e kualitetit të lartë, me dimension A-4, prej 150 gramësh. Në tërë sfondin e fletës është emblema e komunës, kurse në pjesën e sipërme te saj shkruhet: Kuvendi i Komunës së Klinës, numri dhe data e dhënies se titullit. Në mesin e fletës shkruhet: „Mirënjohje” ose „Falënderim”, me emrin dhe mbiemrin e fituesit, nën të motivacioni i dhënies se saj, kurse në fund te saj shkruhet organi apo emri dhe mbiemri i dhënësit të saj dhe vula e Komunës.
3. Iniciativat dhe propozimet mund të vijnë nga organet komunale, institucionet e tjera arsimore, kulturore, sportive, shoqëria civile dhe qytetarët. Me rastin e Ditës së Çlirimtës Klinës „18 qershorit,, Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini, dhe Sport organizon aktivitete të larmishme sportive dhe jep mirënjohje për këtë lëmi.

4. Mirënjojet dhe falenderimet i jep Kryetari i Komunës, Drejtoret e drejtorive dhe Drejtoret e institacioneve tjera vartëse të komunës.

5. Të gjitha Institucionet, të cilat japid mirënjoje falënderime, janë të obliguara të mbajnë evidencë, protokol ose regjistër të veçantë me të gjitha shënimet për lëshimin dhe dhënjen e tyre.

#### Neni 14

#### **Procedura, mënyra dhe kushtet për ndarjën e titujve të nderit, çmimeve dhe shpërblimeve tjera**

##### **Formimi i komisionit vlerësues**

1. Kuvendi i Komunës, sipas propozimit të Kryetarit të Komunës për ndarjen e titujve, çmimeve, dhënien e dekoratave, medaljeve dhe shpërblimeve të tjera të parapara me këtë Rregullore, formon komision të veçantët vlerësues ad hoc për secilin titull-shpërblim.

2. Kuvendi i Komunës do të marrë vendim te veçantë për përbërjen e komisioneve në përputhje me dispozitat ligjore të Statutit të Komunës, të rregulloreve të tjera në fuqi dhe të kësaj rregulloreje.

3 Përbërja e komisionit nga parag. 1 i këtij neni ka 7 anëtar prej të cilve 2 (dy) anëtar i cakton Kryetari i Komunës nga Ekzekutivi, 4 (katër) anëtar caktohën nga legjislativi i komunës dhe 1 (një) anëtar caktohet nga Shoqëria civile.

4. Antëtar i komisionit nuk mund të jetë personi i cili është propozuar e asë personat tjerë të cilet kan çfardo afersie ose interesë më kanidatin e propozuar. Në rastet kur komisioni nuk ka pasur njohuri, Kryetari i Komunës e anulon propozimin për kandidatin e tillë.

5. Komisionet për punën e tyre mund të nxjerrin akte të tjera të veçanta, të cilat në mënyrë më të detajizuar përcaktojnë procedurën e punës. Ato duhet jenë në harmoni me dispozitat e kësaj rregulloreje.

6. Mbledhjet e Komisioneve janë publike dhe për takimet e tyre punuese dhe rezultatet mbahet procesverbal i vegant.

7. Komisionet kanë të drejtë të kërkojnë përkrahje financiare nga buxheti i Komunës për shpenzimet qe lidhen me punën e tyre.

#### Neni 15

1. Komisioni vendimin për nominim e merr më shumicë votash.

2. Në raste të veqanta, komisioni mund të kërkoj ekspertizë për vlerësimin e propozimit për shperblim.

3. Nese në komision vijn dy apo më shumë propozime të një vlere apo rëndësie atëhere komisioni vlerësues përcakton kriteret për përgjedhjen e njërit më votim të fshehtë, më short ose duke e ndar në dy pjesë shpërblimin.

4. Komisioni për vlerësim mund të mos përgjedhë kandidatet e propozuar, nese:

- 4.1 Nuk i plotësojn kushtet dhe kriteret e kësaj rregullorje,
- 4.2 Mungojn të dhëna dhe argumente për propozimet, dhe
- 4.3 Vlerëson se asnje propozim nuk është i merituar.

#### Neni 16

1. Për ndarjen e titullit "Pena e artë", Kuvendi Komunal do të vendosë për publikimin e konkursit publik, në përputhje me dispozitat ligjore Statutin e Komunës dhe të dispozitave të kësaj rregulloreje.

2. Ne vendimin për publikimin e konkursit publik, nga parografi 16.1, por edhe ne tekstin e konkursit publik, do të specifikohen të gjitha kriteret e nevojshme siç janë: lloji i shpërblimit, çmimi i fituar, afati i konkurrimit dhe dokumentet e tjera relevante.

#### Neni 17

1. Kuvendi i Komunës shqyrton propozimet e komisioneve për ndarjen e tituve apo çmimeve të tjera dhe merr vendim me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, Statutit te Komunës dhe të akteve të tjera në fuqi.

2. Votimi do të jetë publik, por Kuvendi mund të vendosë që votimi të jetë me vota të fshehta.

3. Nëse vendos qe votimi të bëhet me vota të fshehta, Kuvendi do të formojë komisionet kompetente për përcjelljen e votimit, sipas dispozitave ligjore, Statutit te Komunës, Rregullores për Punën e Kuvendit dhe të dispozitave të kësaj rregulloreje.

#### Neni 18

1. Pas marrjes së vendimit për ndarjen e titullit te caktuar, apo të ndonjë çmimi tjetër, Kuvendi i Komunës do të organizoj seancën solemne dhe ceremonin e dorzimit dhe vendimin e lexon Kryesuesi i Kuvendit i cili e fton Kryetarin e Komunës qe ta dorzoj titullin apo shpërblimin tjetër qe ndahet.

2. Organizimin e ceremonisë se dhënies së titujve të nderit dhe të shpërblimeve të tjera Kuvendi e bën në bashkëpunim me organet kompetente të administratës kommunale, në përputhje me dispozitat e Rregullores së punës së Kuvendit dhe të akteve të tjera në fuqi.

3. Me rastin e ndarjes së titullit, medaljeve dhe çmimeve të tjera, Kuvendi i Komunës mund të vendosë me vendim të veçantë që ata tituj dhe shpërblime tjera të përcillen edhe me shuma të caktuara financiare.

#### Neni 19

1. Titujt, çmimet, dhe shpërblimet e tjera zakonisht mund të jepen gjatë organizimit të ceremonive, me rastin e ditëve të festave, apo në ditët përkujtimore, por edhe gjatë takimeve, kontakteve me subjektet komunale dhe vizitave që i bëjnë personalitetet e shquara qytetit të Klinës.

2. Mirënjojet dhe falënderimet zakonisht u ndahen personaliteteve të shquara me rastin e mbajtjes se turnireve sportive, shfaqjeve, tubimeve dhe datave të tjera me rëndësi.

#### Neni 20

##### Bartja dhe revokimi i titujve

1. Bartësi i titullit është i obliguar qe titullin ta bartë me dinjitet, duke pasur parasysh çdo herë sjelljet e tija në jetë dhe angazhimin e përditshëm dhe të ruajë autoritetin e Kuvendit te Komunës.

2. Bartësit te titullit mund t'i revokohet titulli, nëse ai me sjelljet e veta në shkallë të lartë e njollos institucionin e Kuvendit te Komunës, ose në bazë te aktgjykimit të plotfuqishëm të gjykatës, dënohet me dënim burgu prej se paku gjashtë muaj.

3. Revokimi bëhet ne procedurën e njejt të paraparë paraprake si për dhënien e titullit, ndërsa vendimi përfundimtar merret në mbledhje të rregullt të Kuvendit të Komunës.

#### Neni 21

## II. DISPOZITAT E FUNDIT DHE PËRFUNDIMTARE

Në rast të kolezionit të dispozitave të kësaj rregullorje me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale-LVL-ën si dhe akteve të tjera të Pushtetit qendror dhe ministror të linjës, si dhe në raste të zbrazësirës tjetër juridike, në këtë rregullore, drejtpërsëdrejti vlejnë dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 i dt. 20 shkurt 2008, apo edhe dispozitat e tjera të

Pushtetit qendror dhe ministrisë kompetente të linjës qe rregullon çeshtjen lëndore deri në harmonizimin ligjor të këtij akti.

Neni 22  
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të ministrisë përgjegjese për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhet zyrtare në ueb faqën zyrtare të komunës, kjo në kuptim të nenit 18 të Rregullorës se Qeverisë se Republikës se Kosovës nr. 01/2013 dt.24.01.2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të akteve komunale.

Nr. 01-06-9914/2015  
Klinë, më dt. 20. 07. 2015.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

